



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2020:153542

Datë: 05.02.2024

Numri i dokumentit: 05282944

C.nr. 18/22

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin individual Genc Hasani, në çështjen juridike të paditëses Rr. M. nga M., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokat Uvejs Gashi nga Mitrovica, kundër të paditurës Komuna e Leposaviqit Drejtoria për Kulture dhe Arsim, baza juridike, kontest nga marrëdhënia e punës, më datë 05.02.2024 jashtë seancës gjyqësore nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET MARRËVESHJA JASHTËGJYQËSORE me numër C.nr.18/22 e datës 10.01.2024 (Nd:...) e arritur në procedurën e ndërmjetësimit, në mes paditëses Rrezarta Mustafa nga Mitrovica,, kundër të paditurës Komuna e Leposaviqit dhe e njëjta marrëveshje ka fuqinë e titullit ekzekutiv-përmbarues.

Arsyetim

Paditësja me datën ... pranë kësaj gjykate kanë paraqitur padinë për kompensimi i shujtës ushqimore për periudhën kohore ...-...

Me datën ..., gjykata është njoftuar se palët kanë arritur marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit pranë ndërmjetësuesit B. I. i cili këtë marrëveshje me shkrim i'a ka dorëzuar gjykatës.

Gjykata, pas analizimit të shkresave të cilat gjinden në lëndë konsiderojë se janë plotësuar kushtet për aprovimin e kësaj marrëveshje të arritur në procedurën e ndërmjetësimit dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Sipas nenit 15 paragrafi 4 i Ligjit për Ndërmjetësimin *“Nëse Ndërmjetësimi fillon me vetëinicimin e palëve, marrëveshja e arritur me shkrim e nënshkruar nga palët dhe ndërmjetësuesi, e cila përmban klauzolën (vërtetimin) mbi plotfuqishmërinë dhe ekzekutueshmërinë e marrëveshjes, ka fuqinë e dokumentit përmbarues në përputhje me ligjin përkatës për procedurën përmbarimore.”*

Prandaj, gjykata, bazuar në arsyet e cekura më lartë, e duke u bazuar në dispozitën e nenit 15 paragrafi 4 të Ligjit për ndërmjetësimin, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
C.nr.18/22, me datë 05.02.2024

Gjyqtari
Genc Hasani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet e drejta në ankesë.